



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.19

2001

Prill

P Ë R M B A J T J A

Ligji nr.8762, datë 2.4.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Hipotekimit për ndërtimin e hidrocentralit të Bushatit”.....	563
Ligji nr.8763, datë 2.4.2001	Për një shtesë në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”.....	567
Ligji nr.8764, datë 2.4.2001	Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.1, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për lejimin për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm të një anijeje ushtarake franceze në Portin e Durrësit”.....	568
Ligji nr. 8765, datë 2.4.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8113, datë 28.3.1996 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”..	569
Ligji nr. 8766, datë 5.4.2001	Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin.....	570

Ligj nr. 8767, datë 5.4.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjet nr.8039, datë 23.11.1995, nr.8074, datë 22.2.1996 dhe nr. 8112, datë 28.3.1996.....	582
Vendim i Kuvendit nr.483, datë 2.4.2001	Për caktimin e deputetëve që do të marrin pjesë në Komisionin për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik	588
Vendim i Kuvendit nr.484, datë 2.4.2001	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).....	588
Dekret nr.2973, datë 19.4.2001	Për lënie të shtetësisë shqiptare.....	589
Dekret nr.2975, datë 20.4.2001	Për emërimin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.....	590
Dekret nr.2979, datë 20.4.2001	Për lirim ministri.....	590
Dekret nr.2980, datë 20.4.2001	Për emërim ministri.....	591
Vendim i KM nr.174, datë 30.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”.....	591
Vendim i KM nr.176, datë 30.3.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.531, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për tokat bujqësore të pandara”.....	592
Vendim i KM nr.178, datë 30.3.2001	Për bashkimin e Qendrës Kombëtare të Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit me Institutin e Shëndetit Publik.....	593
Udhëzim nr.23, datë 17.4.2001	Për mënyrën e verifikimit nga KZQV-të të rekordeve të dubluara në Listën A të zgjedhësve.....	593
Udhëzim nr.24, datë 18.4.2001	Për vënien në dispozicion të subjekteve zgjedhore të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e Kuvendit 2001.....	594

L I G J
Nr.8762, datë 2.4.2001

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HIPOTEKIMIT PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALIT TË BUSHATIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e hipotekimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe bankës kineze “EXIM Bank” për ndërtimin e Hidrocentralit të Bushatit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2965, datë 9.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

MARRËVESHJE HIPOTEKIMI

Në rastin kur:

Banka Eksport-Import e Kinës (e paraqitur si “EXIM Bank”) ka rënë dakord që me anë të një Marrëveshje Kredie të Blerësit të datës 9 shkurt 2001 (që sot e tutje e cilësuar si “Marrëveshja e Kredisë”), të japë një kredi lehtësuese deri në shumën 119,728,000.00 USD (njëqind e nëntë mbëdhjetë milion e shtatëqind e njëzet e tetëmijë USD) në dispozicion të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (që sot e tutje e cilësuar si Humarrësi), e përfaqësuar nga Ministria e saj e Financës;

Me qëllim që të plotësojë parakushtet e Marrëveshjes së Kredisë, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit e Republikës së Shqipërisë, në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, dhe si aksioner i vetëm i Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), në emër të KESH-it gjithashtu, ka rënë dakord të ekzekutojë dhe dorëzojë këtë Marrëveshje Hipotekimi;

Po të mos jetë përcaktuar ndryshe në këtë dokument, shprehjet në nenin 1 të Marrëveshjes së Kredisë do të aplikohet në këtë Marrëveshje Hipotekimi.

Prandaj “EXIM Bank” dhe Pengëdhënësi bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Si garanci për rimbursim të plotë në favor të “EXIM Bank” të të gjitha shumave në zbatim (ose në pajtim) të Marrëveshjes së Kredisë si dhe të gjitha pretendimeve, përgjegjësisive, humbjeve dhe shpenzimeve të ndërrmarra nga “EXIM Bank” në lidhje me Kontratën e Kreditimit ose këtë Marrëveshje Hipotekimi, Hipotekuesi është dakord të sigurojë, si më poshtë garanci (hipoteke) në favor të “EXIM Bank” mbi të gjitha pronësitë e saj, sipas Projektit të kondicionuar në Kontratën e Hipotekimit duke përfshirë asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të drejtat dhe interesat e domosdoshme për funksionimin e Projektit të bashkangjitur që sot e tutje të cilësuar si kolateral).

Brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Hipotekimit, Hipotekuesi do të depozitojë për regjistrim në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Marrëveshjen e

ratifikuar, listën e asetëve të hipotekuara (kolateralin) dhe projektin. Menjëherë, pasi ky proces ka përfunduar, Hipotekuesi do t'i paraqesë "EXIM Bank"-ës gjithë dokumentet përkatëse që vërtetojnë se një regjistrim i tillë është kryer në mënyrën e duhur.

Neni 2

Hipotekuesi është dakord të hipotekojë të gjitha asetet e mëpotshme, sipas Projektit për EXIMBANK:

2.1 asetë eksiztuese që përfshijnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;

2.2 të gjitha të drejtat e pakushtëzuara të nevojshme për realizimin e Projektit, siç janë parashikuar në këtë Marrëveshje Hipotekimi.

Një listë asetesh hipotekimi duhet të detajohet nga Hipotekuesi, tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi.

Brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Hipotekimit, Hipotekuesi do të depozitojë për regjistrim në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Marrëveshjen e ratifikuar, listën e asetëve të hipotekuara (kolateralin) dhe projektin. Menjëherë, pasi ky proces ka përfunduar, Hipotekuesi do t'i paraqesë "EXIM Bank"-ës gjithë dokumentet përkatëse që vërtetojnë se një regjistrim i tillë është kryer në mënyrën e duhur.

Neni 3

Të gjitha formalitetet e brendshme të hipotekës, duke përfshirë por jo kufizuar renditjen e asetëve të saj për hipotekim, siç është parashikuar në nenin 2.1 dhe nenin 2.2, si dhe regjistrimi i të drejtave të hipotekimit tek autoritetet duhet të plotësohet nga Hipotekuesi. Të gjitha dokumentet e nevojshme për të vërtetuar ekzistencën ligjore të të drjetave hipotekuese të "EXIM Bank"-ës ndaj asetëve të hipotekimit, duke përfshirë, por jo kufizuar nga formalitetet e regjistrimit, duhet t'i dorëzohen "EXIM Bank"-ës, jo më vonë se në fund të muajit të gjashtëdhjetë (60) qysh nga Pagesa e Parë të përcaktuar në Kontratën e Kreditimit, nëse të gjitha palët kontraktuese të Kontratës së Hipotekimit bien dakord ta zgjasin aftin.

Neni 4

Pavarësisht nga kjo Marrëveshje Hipotekimi, për aq kohë sa nuk ka ndonjë pengesë (mospagim, mosplotësim detyrimi), sipas Marrëveshjes së Kredisë, Hipotekuesi mund të vazhdojë të ketë nën pronësi, të përdorë dhe menaxhojë të gjithë kolateralin. Në rast të mosplotësimit të ndonjë detyrimi sipas Marrëveshjes së kredisë, dhe/ose Kontratës së Hipotekimit, dhe/ose dokumenteve të tjera të bashkëngjitura, "EXIM Bank", në çdo kohë pas tridhjetë (30) ditësh të paralajmërimit me shkrim për ngjarjen Hipotekuesit mund të deklarojnë që garancia për këtë Marrëveshje Hipotekimi bëhet menjëherë e zbatueshme, nëse Hipotekuesi nuk përmbush, në mënyrën e duhur, detyrimin e tij gjatë kësaj periudhe.

Neni 5

Interesi i garancisë së përshkuar në këtë Marrëveshje Hipotekimi përfaqëson një të drejtë të parë të vlefshme dhe interes garancie në kolateral, duke patur prioritet ndaj të drejtave të të gjitha palëve të treta.

Neni 6

Në çdo kohë pasi garancia e sanksionuar bëhet e ligjshme dhe efektive sipas nenit 9 të kësaj marrëveshjeje Hipotekimi, "EXIM Bank" do të ketë të drejtën për ta ezekutuar si vijon:

6.1 "EXIM Bank", me kërkesën e saj:

6.1.1 do t'i kërkojë Zyrës së Përmbartimit të ndjekë procedurat ligjore, me qëllim që të ekzekutojë këtë marrëveshje;

6.1.2 do të gëzojë të drejtën të përdorë, operojë dhe menaxhojë kolateralin, sipas dëshirës së vet, dhe do të mbledhë të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i kolateralit, vetë apo nëpërmjet të tretëve, derisa të përmbushet i gjithë obligimi. Pas kësaj "EXIM Bank" do t'i kthejë kolateralin Hipotekuesit.

6.2 Zyra e Përmbartimit, me kërkesë të "EXIM Bank"-ës, do të kryejë shitjen publike të kolateralit dhe të të drejtave, titujve dhe interesave, nëpërmjet procedurës së ankandit. Zyra e Përmbartimit do të njoftojë me shkrim, paraprakisht 10 ditë pune, Hipotekuesin për qëllimin e saj për të disponuar kolateralin, përveç rastit kur Hipotekuesi, brenda afatit 10 ditor, do të ketë paguar shumën që i detyrohet "EXIM Bank" -ës. Hipotekuesi bie dakord që, në rastin kur do të ndodhë kjo, ai, automatikisht, do të heqë dorë nga e drejta për të rimarrë kolateralin dhe do të lirohet nga ndonjë miratim i mëtejshëm apo veprim tjetër.

6.3 të përdorë të ardhurat e çdo dorëzimi sipas nenit 6, më sipër duke zbatuar rrjedhimisht prioritetet si vijon:

6.3.1 të përballojë koston dhe shpenzimet e çdo lloji lidhur me dorëzimin;

6.3.2 të paguajë ose përmbushë të gjitha detyrimet e garantuara.

Nëse të ardhurat (plus çdo shumë disponibël për shkak të kontratës së caktimit të aseteve të parashikuara) i kalojnë pagesat sipas nenit 6.1 dhe nenit 6.2 më sipër, pjesa që mbetet do t'i kthehet Humarrësit; dhe

Nëse të ardhurat (plus çdo shumë në dispozicion të kontratës së caktimit të aseteve të parashikuara) janë më pak se pagesat sipas nenit 6.1 dhe nenit 6.2 më sipër, Humarrësi do të ketë përgjegjësi t'i paguajë diferencën "EXIM Bank" -ës.

Neni 7

Hipotekuesi garanton dhe kontrakton:

7.1 të sigurojë që kolaterali ekziston ligjërisht, drejtëpërsëdrejti dhe në pronësi të vetë vetes si përfitues dhe që kolaterali është i lirë dhe i qartë nga çdo pretendim, e drejtë, barrë, detyrime apo ineteresa garancie të çdo lloji, përveç atij të krijuar nga nga kjo Marrëveshje Hipotekimi. Hipotekuesi që sot e tutje nuk do të krijojë pretendime, të drejta, barrë, detyrime apo interesa garancie të çdo lloji në kolateral.

7.2 të sigurojë që i gjithë kolaterali për të cilin flitet në këtë Marrëveshje Hipotekimi do të ruhet, mirëmbahet dhe menaxhohet në kushte të mira dhe është siguruar, sipas një police sigurimi komerciale, e cila mbulon të gjithë humbjen e kolateralit, përkundrejt riskut normal të aseteve nga një kompani sigurimi e besueshme me famë; si dhe të gjitha të drejtat në bazë të policisë së sigurimit do t'i transferohen "EXIM Bank" -ës si të drejta pa kushte të garancisë së ritransferueshme.

7.3 të abstenojë nga deklarimi apo nisja, pa miratimin e mëparshëm të "EXIM Bank" -ës me shkrim të falimentimit, likuidimit apo mbarimit para përfundimit të kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi;

7.4 të procedojë, me ngulm, për ndërtimin e projektit dhe të marrë të gjithë hapat dhe masat e nevojshme për të siguruar ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi; si dhe

7.5 të përballojë të gjitha shpenzimet e ndërmarra, në lidhje me përgatitjen, regjistrimin dhe zbatimin të kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi, si dhe mbrojtjen e të drejtave e interesave në fjalë.

Neni 8

Hipotekuesi ndërmerr që me shpenzimet e veta, ajo herë pas here, me kërkesën e EXIMBANK-ës, të ekzekutojë ose sigurojë ashtu si duhet dhe në kohën e duhur, ekzekutimin e të gjitha dokumenteve, siç mund t'i kërkojë "EXIM Bank", në mënyrë që të mbrojë ose përsosë garancinë për kolateralin ose me qëllim që të realizojë kolateralin dhe të ushtrojë të gjithë pushtetin, të drejtat dhe interesat të mishëruara në "EXIM Bank".

Neni 9

Kontrata e hipotekimit do të hyjë në fuqi në datën e ratifikimit nga Parlamenti Shqiptar dhe përfundon kur:

9.1 të gjitha shumat, që janë ose mund të bëhen të pagueshme sipas kushteve të Marrëveshjes së Kredisë, janë paguar tërësisht dhe përfundimisht dhe “EXIM Bank” pushon së pasuri ndonjë përgjegjësi aktuale apo të rastit në këtë aspekt dhe

9.2 “EXIM Bank” të ketë marrë pagesë të plotë, të pakthyeshme dhe përfundimtare plotësim të shumave, detyrimeve dhe përgjegjësi të siguruara në këtë dokument.

Neni 10

“EXIM Bank”, në çdo kohë, mund të caktojë me vullnetin e saj të drejtat, sipas kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi ndaj çdo pale tjetër të tretë, dhe do të informojë Hipotekuesin me shkrim, brenda një kohe të arsyeshme.

Neni 11

Përveç rastit të mospërmbushjes së detyrimit, sipas Marrëveshjes së Kredisë, ngjarja e ndonjë nga situatave të mëposhtme, ajo do të koniderohet një mospërmbushje e detyrimit, sipas kësaj Kontrate të Hipotekimit në rast se Humarrësi nuk paguan 3 (tre) këste të njëpasnjëshme sipas Skedulit të ripagimit; ose

11.1 Hipotekuesi shkel kontratën, sipas ndonjë kushti, apo dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi ; ose

11.2 çdo garanci apo marrëveshje e bërë apo e lëshuar nga Hipotekuesi në këtë dokument ose në një deklaratë tjetër, e bërë ndryshe nga ajo e një çerfitikate, opinionit ose dokumentit tjetër i paraqitur në lidhje me këtë Marrëveshje Hipotekimi vërtetohet të ketë qenë i pasaktë apo i rremë kur është bërë, lëshuar apo gjykuar të jetë dhënë; ose

11.3 në rast se kreditorë të tjerë përveç “EXIM Bank” ngrejnë një pretendim kundër ose fitojnë një barrë apo një urdhër nga ndonjë juridiskion kundër Hipotekuesit në lidhje me Projektin dhe/ose asetëve të tij; apo ndonjë transfertë, caktimi apo sugjerimi të dëshirës së transfertës, dorëzimit të çdo aseti përgjithësisht debitorit të tij; ose

11.4 vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi do të kontestohet nga Hipotekuesi ose Hipotekuesi do të mohojë përgjithësisht përgjegjësinë që ka sipas kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi (qoftë nga ndërpreja e përgjithshme e pagesave ose një moratorium në pagesën e detyrimeve në përgjithësi ose ndryshe); apo do të ketë ndonjë ndryshim në ndonjë traktat, në të cilin Vendi i Hipotekuesit është një palë ose çdo ligji, rregullore apo politike e Vëndit të Hipotekuesit, apo çdo urdhër i ndonjë autoriteti kompetent ose vendim i çdo gjykate me juridiksion kompetent, e cila mund të bëjë apo synon të bëjë çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi të paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme ose që mund të pengojë apo vonojë ekzekutimin ose vëzhgimin nga Hipotekuesi të detyrimeve të tij si vijon; ose

11.5 importuesi pezullon, ose kërcënon të pushojë së kryeri funksionin e tij; ose

11.6 çdo pranim licence, aprovimi apo autorizimi te, ose çdo paraqitje apo regjistrim me, çdo autoritet apo agjenci qeveritare e domosdoshme për vlefshmërinë apo ardhjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi ose kryerja apo ekzekutimi nga ana e Hipotekuesit të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi siç mund të paraqitet rasti, ose çdo marrëveshje apo instrument i kërkuar në vijim ose pranimin faktikisht të kësaj Marrëveshjeje Hipotekimi do të revokohet, nuk do të lëshohet ose rinovohet në kohë, apo të pushojë së qeni në fuqi dhe veprim të plotë.

Neni 12

Kjo Marrëveshje Hipotekimi do të udhëhiqet nga Ligji Shqiptar.

Kjo Marrëveshje Hipotekimi është nënshkruar më 9 shkurt 2001, nga Banka Eksport-Import e Kinës.

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit

Z. Yang Zilin
Kryetar dhe President
Banka Eksport-Import e Kinës

Z. Mustafa Muçi
Ministër i Ministrisë së Ekonomisë Publike
dhe Privatizimit

L I G J
Nr.8763, datë 2.4.2001

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7908, DATË 5.4.1995
“PËR PESHKIMIN DHE AKUAKULTURËN”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën” bëhet kjo shtesë:

Pas pikës 6 të nenit 27 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“Sipërfaqet ujore të Republikës së Shqipërisë u jepen me qira subjekteve juridike e fizike, për të ushtruar veprimtarinë e akuakulturës intensive, me synim shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Procedurat dhe vlerat e qirasë, sipas kategorive ujore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për miratimin e sipërfaqeve ujore, të përcaktuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, për dhënien me qira për qëllimin e mësipërm, të merret edhe mendimi i Komitetit të Zhvillimit të Turizimit, i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe i Sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Ujit.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2968, datë 18.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8764, datë 2.4.2001

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV ME FUQINË E LIGJIT NR.1, DATË 26.2.2001
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LEJIMIN PËR HYRJE DHE QËNDRIM TË
PËRKOHSHËM TË NJË ANIJEJE USHTARAKE FRANCEZE NË PORTIN E DURRËSIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit nr.1, datë 26.2.2001 i Këshillit të Ministrave “Për lejimin për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm të një anijeje ushtarake franceze në Portin e Durrësit”.

**Shpallur me dekretin nr.2969, datë 18.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

A K T N O R M A T I V
Nr.1, datë 26.2.2001

**PËR LEJIMIN PËR HYRJE DHE QËNDRIM TË PËRKOHSHËM, TË NJË ANIJEJE
USHTARAKE FRANCEZE, NË PORTIN E DURRËSIT**

Më mbështetje të neneve 12 pika 3 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Neni 1

Dhënien e lejes për hyrje dhe qëndrim të përkohshëm, nga data 2 deri më 5 mars 2001, në Portin e Durrësit, të anijes ushtarake franceze “Commandant BIROT”.

Neni 2

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për mbarëvajtjen e këtij qëndrimi.

Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

L I G J
Nr.8765, datë 2.4.2001

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8113, DATË 28.3.1996 “PËR
DEKORATAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Në nenin 1, pas fjalëve “shtetasve shqiptarë ose të huaj”, shtohen fjalët “si dhe personave juridikë,”.

Neni 2

- Në nenin 3 pika 4, emërtimi “Mjeshtër i Madh i Punës” ndryshohet në “Mjeshtër i Madh”.

- Në po këtë nen shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:
“11. Medalja “Për Merita të Veçana Civile”

Neni 3

Në nenin 8 titulli ndryshohet në “Urdhri “Mjeshtër i Madh””.

Neni 4

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:
“Medalja “Për Merita të Veçanta Civile”

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për merita të veçanta civile në Shqipëri. Kjo medalje do të jetë e artë.”

Neni 5

Urdhri “Mjeshtër i Madh i Punës”, i dhënë deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, njihet si Urdhri “Mjeshtër i Madh”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2970, datë 18.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

L I G J
Nr.8766, datë 5 .4.2001

PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Misioni

1. Mbrojtja e jetës së njerëzve dhe e pronës nga rreziku i zjarrit dhe i fatkeqësive natyrore e fatkeqësive të tjera në rastet e emergjencave, është detyrë e organeve shtetërore, e ministrive dhe institucioneve qendrore, e organeve të qeverisjes vendore, e organeve të specializuara, e personave juridikë e fizikë vendas ose të huaj.

2. Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit (PMNZSH) ka si qëllim parandalimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës nga rreziku i zjarrit, kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë, dhënien e asistencës teknike, si dhe ndërhyrjen në rastet e emergjencave e të fatkeqësive natyrore e fatkeqësive të tjera.

3. Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit (PMNZSH) është pjesë e administratës, në përbërje të strukturës së Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe e strukturave të prefektit. Strukturat e mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit krijohen edhe në organet e qeverisjes vendore, në objektet me rëndësi shtetërore dhe në personat juridikë e fizikë, mbështetur në normat teknike.

4. PMNZSH-ja është organ shtetëror i specializuar i gatishmërisë së përhershme.

5. Veprimtaria e PMNZSH-së bazohet në ligj, në akte nënligjore të nxjerra në bazë dhe në zbatim të tyre dhe në normat teknike ndërkombëtare të pranuar.

KREU II
STRUKTURA E POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI
DHE E SHPËTIMIT

Neni 2
Organizimi i strukturave shtetërore

Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit përbëhet nga:

I. Drejtoria e PMNZSH-së.

1. Në Ministrinë e Pushtetit Vendor, brenda Departamentit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, funksionon Drejtoria e PMNZSH-së.

2. Drejtoria e PMNZSH-së është autoriteti më i lartë teknik dhe profesional për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Ajo e përfaqëson këtë polici në marrëdhëniet me organet e tjera të administratës publike, me organizatat joqeveritare, me komunitetin brenda vendit, si dhe në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare, simotra, në kuadër të programeve të përcaktuara nga Departamenti i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile.

3. Drejtoria e PMNZSH-së përgjigjet për drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë së të gjitha

strukturave të PMNZSH-së në shkallë vendi. Ajo organizon kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë, përgjigjet për formimin, trajnimin e personelit dhe planifikon e bën kompletimin materialo-teknik të stacioneve të mbrojtjes nga zjarri e të shpëtimit në varësi të saj.

II. PMNZSH-ja e qarkut.

1. Në qark funksionon PMNZSH-ja e qarkut në varësi të prefektit.

2) Nën drejtimin e drejtpërdrejtë të PMNZSH-së së qarkut janë:

a) stacionet zjarrfikëse të gatishmërisë së përhershme, të vendosura në qendër të qarkut dhe të rretheve;

b) stacionet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit të gatishmërisë së përhershme, të vendosura në objekte me rëndësi në shkallë vendi;

3. PMNZSH-ja e qarkut kontrollon veprimtarinë e të gjithë strukturave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit që veprojnë në territorin e qarkut.

4. Përbërja e strukturës dhe limiti organik i PMNZSH-së përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

Stacionet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit të gatishmërisë së përhershme

1. Në qendrat e qarqeve dhe të rretheve jo qendër qarku, funksionojnë stacionet e gatishmërisë së përhershme të PMNZSH-së.

2. Stacionet e PMNZSH-së së gatishmërisë të përhershme, janë forca të specializuara. Ato kanë për detyrë shpëtimin e jetës së njerëzve dhe shpëtimin e pronës nga zjarri, ndërhyrjen në rastet e emergjencave nga rreziqet teknologjike dhe industriale në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

3. Ato plotësohen me teknikë e pajisje të domosdoshme, që përdoren vetëm për përmbushjen e misionit të tyre.

4. Shpenzimet për ngritjen, mbajtjen e funksionimin e tyre përballohen nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera, që sigurohen sipas përcaktimeve në nenet e veçanta të këtij ligji.

Neni 4

Stacionet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit në objektet me rëndësi në shkallë vendi

1. Në veprat me rëndësi ekonomike, ushtarake e strategjike, në shkallë vendi, si porte, aeroporte, qyteza turistike dhe territore me vlera të veçanta historike, kulturore, arkeologjike, muzeale dhe ekonomike, të përcaktuara të tilla nga Këshilli i Ministrave, garantohet infrastruktura e plotë për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, në përputhje me normat teknike dhe ato ndërkombëtare.

2. Në këto objekte vendosen e krijohen stacionet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit të gatishmërisë së përhershme, të cilat janë në përbërje e limit organik i institucioneve që i administrojnë ose që i kanë në pronësi. Veprimtaria e tyre parësore shtrihet brenda territorit të objekteve, për të cilat janë ngritur.

3. Objektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni plotësohen me teknikë e pajisje si me sisteme sinjalizimi, sisteme stacionare të shuarjes së zjarrit, me hidrante zjarrfikëse dhe me mjete e pajisje të tjera shpëtimi.

4. Ky lloj shërbimi ndërhyr edhe për dhënien e ndihmës jashtë territorit ku ata veprojnë për shpëtimin e jetës së njerëzve e për shpëtimin e pronës nga zjarri, për zhdukjen e pasojave nga rreziqet teknologjike e industriale, si dhe në rastet e emergjencave e të fatkeqësive të tjera, kur një gjë e tillë kërkohet nga prefekti ose nga kryetari i bashkisë ose komunës përkatëse.

5. Shpenzimet për ngritjen dhe funksionimin e këtyre stacioneve përballohen nga personat juridikë, që i kanë në pronësi ose në administrim.

6. Drejtimi metodik dhe kualifikimi profesional i personelit të këtyre stacioneve bëhet nga Drejtoria e PMNZSH-së.

Neni 5
Organizimi në nivel vendor

1. Në bashki ose komuna, me vendim të këshillit përkatës, krijohen stacionet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, në bazë të studimeve të përbashkëta, të bëra nga Drejtoria e PMNZSH-së dhe organet e pushtetit vendor, mbështetur në normat teknike dhe në ato ndërkombëtare.

2. Shpenzimet për ngritjen, mbajtjen dhe funksionimin e tyre përballohen nga buxheti i bashkive ose i komunave.

Neni 6
Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit pranë subjekteve të tjera

1. Persona juridikë dhe fizikë, vendas dhe të huaj, organizojnë shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit për mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe të objekteve që përfshihen në administrimin e tyre, mbështetur në normat teknike dhe në ato ndërkombëtare.

2. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit në subjektet e mësipërme, drejtimi metodik e kualifikimi profesional bëhet nën drejtimin e PMNZSH-së të qarkut.

Neni 7
Shërbimi vullnetar i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit

1. Shërbimi vullnetar i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit organizohet nga:

a) organet e pushtetit vendor në qytete, qendra urbane dhe objekte e institucione, pronë e tyre.

b) personat juridikë dhe fizikë, vendas e të huaj, për veprimtaritë e tyre ekonomike e shoqërore.

2. Mënyra e organizimit, e përgatitjes dhe e shpërblimit të anëtarëve të shërbimit vullnetar të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, në rastet e ndërhyrjeve për zhdukjen e pasojave të shkaktuara nga zjarri, nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, në zbatim të këtij ligji, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor.

Neni 8
Ndarja e personelit

1. Sipas detyrave dhe funksioneve që kryejnë në PMNZSH, punonjësit e shërbimit ndahen në këto nivele: bazë, të mesëm, të lartë dhe madhor.

2. Në punonjësit e nivelit bazë të PMNZSH-së bën pjesë personeli i shërbimit.

3. Në punonjësit e nivelit të mesëm të PMNZSH-së bëjnë pjesë komandanti i stacionit dhe inspektori i parandalimit.

4. Në punonjësit e nivelit të lartë të PMNZSH-së bëjnë pjesë shefi i sektorit të PMNZSH-së pranë prefektit, shefi i sektorit dhe inspektori në Drejtorinë e PMNZSH-së.

5. Në nivelin madhor bën pjesë Drejtori i Drejtorisë së PMNZSH-së.

6. Njesimi i funksioneve të PMNZSH-së me funksionet përkatëse në Policinë e Shtetit bëhet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor.

Neni 9
Gradat në PMNZSH

1. Gradat në PMNZSH fitohen sipas kriterëve dhe roleve. Kriteret për fitimin e gradave janë:

a) arsimi;

b) vjetërsia në shërbim;

c) kualifikimi profesional;

- ç) karriera në strukturat e PMNZSH-së.
2. Gradimet për rolin e mesëm e të lartë bëhen me urdhër të Ministrit të Pushtetit Vendor, me propozim të Komisionit të Gradave.
3. Gradimet për rolin bazë të PMNZSH-së bëhen me urdhër të Drejtorit të PMNZSH-së, me propozim të Komisionit të Gradave.
4. Përbërja e funksionimi i Komisionit të Gradave përcaktohet me urdhër të Ministrit të Pushtetit Vendor.

Neni 10 **Pranimi në PMNZSH**

1. Për nivelin bazë:
Për këtë nivel mund të konkurrojnë për punonjës të këtij shërbimi shtetasit shqiptarë, pa dallim, që plotësojnë këto kushte:
- a) kanë kryer shkollën e mesme;
 - b) kanë kryer shërbimin e detyruar ushtarak;
 - c) janë nën moshën 35 vjeç;
 - ç) nuk janë dënuar nga gjykata për kryerjen e një vepre penale,
 - d) gëzojnë shëndet të mirë dhe aftësi fizike për të kryer detyra të veçanta me rrezik të shtuar.
2. Për nivelin e mesëm dhe të lartë:
Në këto nivele konkurrojnë ata persona që kanë kryer Akademinë e Rendit Publik ose Universitetin Politeknik, në bazë të testimit të bërë nga Drejtorja e PMNZSH-së.

Neni 11 **Formimi dhe trajnimi**

Punonjësit e PMNZSH-së i nënshtrohen formimit dhe trajnimit në kurset pranë Shkollës së Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe në Qendrën e Trajnimit të Emergjencave Civile.

Neni 12 **Emërimi dhe lirimi nga detyra**

1. Emërimi dhe lirimi nga detyra e Drejtorit të PMNZSH-së bëhet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor.
2. Marrja e titullit oficer i PMNZSH-së dhe heqja e këtij titulli bëhen nga Ministri i Pushtetit Vendor, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr.8643, datë 20.7.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit".
3. Emërimi dhe lirimi nga detyra e personelit oficer, në përbërje të strukturës së PMNZSH-së bëhet nga Ministri i Pushtetit Vendor.
4. Emërimi dhe lirimi nga detyra i personelit të shërbimit në strukturat e prefektit bëhet nga prefekti me propozim të shefit të PMNZSH-së.

Neni 13 **Largimet dhe përjashtimet**

1. Punonjësi i PMNZSH-së largohet nga detyra:
- a) kur mbush moshën për pension;
 - b) kur bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për 6 muaj ose me vendim të komisionit mjekësor;
 - c) kur kërkohet nga ai vetë, pasi ka plotësuar kushtet e kontratës së pranimit;
 - ç) kur shkurtohet funksioni organik.
2. Punonjësi i PMNZSH-së përjashtohet në rastet e mëposhtme:

- a) Kur kryen në mënyrë të përsëritur thyerje të rënda të disiplinës.
- b) Kur nuk paraqitet në punë pa shkaqe të arsyetuara mbi 7 ditë.
- c) Kur është pranuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në këtë ligj.
- ç) Kur dënohet penalisht me vendim gjykate të formës së prerë.

Neni 14

Qëndrimi ndaj shërbimit

1. Punonjësit të PMNZSH-së i ndalohet, në çdo rast, të largohet nga shërbimi, veçse me urdhër ose leje të eprorit.
2. Punonjësit të PMNZSH-së i ndalohet që gjatë shërbimit të kryejë veprime ose sjellje që bien ndesh me përmbushjen e detyrës.
3. Punonjësit e PMNZSH-së janë të detyruar t'u përgjigjen me korrektësi dhe shpejtësi gjendjes së gatishmërisë në sektorin ose stacionin zjarrfikës, ku ata shërbejnë.
4. Kur e kërkojnë nevojat e shërbimit, punonjësit e PMNZSH-së janë të detyruar të punojnë edhe jashtë orarit të punës, kundrejt shpërblimit.

Neni 15

Paprekshmëria

1. Fyerja, kundërshtimi dhe çdo veprim tjetër i dhunshëm ndaj punonjësit të PMNZSH-së dënohet sipas dispozitave të Kodit Penal.
2. Kur atij, për shkak të shërbimit, i rrezikohet jeta, familja ose i dëmtohet prona, shteti i garanton mbrojtje të veçantë. Kushtet dhe mënyra e përfitimit të saj janë të njëjta me ato të Policisë së Shtetit, të përcaktuara në dispozita të veçanta.
3. Punonjësi i PMNZSH-së nuk mund të ndiqet penalisht nëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë për shuarjen e zjarrit dhe të shpëtimit shkakton dëme anësore, përjashtuar rastet kur vërtetohet se ato janë bërë me qëllim.
4. Statusi i punonjësit të PMNZSH-së, i përcaktuar me këtë ligj, nuk ndryshon edhe në kushtet e gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme ose të rasteve të emergjencave ose të fatkeqësive të tjera. Ai zbaton masat e jashtëzakonshme në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin përkatës.

Neni 16

Uniforma, stema dhe gradat

1. PMNZSH-ja ka uniformë të veçantë me shenja dalluese përkatëse, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Sistemi i gradave funksionon sipas përcaktimeve në ligjin nr.8643, datë 20.7.200 "Për gradat në Policinë e Shtetit".

KREU III

BUXHETI DHE MARRËDHËNIET ME ADMINISTRATËN PUBLIKE

Neni 17

Buxheti

1. Buxheti i strukturës shtetërore të PMNZSH-së është pjesë e Buxhetit të Shtetit, miratuar për Ministrinë e Pushtetit Vendor, me titull dhe kre të veçantë.
2. Buxheti i strukturës shtetërore të PMNZSH-së përbëhet dhe nga të ardhurat që krijohen nga:
 - a) taksat e sigurimit nga zjarri, sipas përcaktimit me ligj;
 - b) tarifat e shërbimeve që kryhen ndaj të tretëve;

- c) gjobat;
- ç) dhurues të ndryshëm;
- d) forma të tjera të njohura me ligj.

3. Pasqyrimi, administrimi dhe mënyra e përdorimit të të ardhurave të përkufizuara në pikën 2 të këtij neni, në interes të Drejtorisë së PMNZSH-së, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Marrëdhëniet me shoqëritë e sigurimeve

1. PMNZSH-ja dhe shoqëritë e sigurimeve, bashkëpunimin e tyre e realizojnë nëpërmjet kontratave që lidhin për caktimin e kushteve teknike për objektet që sigurohen nga zjarri dhe në rastet e ekspertizës teknike të zjarreve të rëna në to.

2. Specialisti i PMNZSH-së, në rast zjarri në objektin e siguruar bën sipas kërkesës së shoqërisë të sigurimit, aktin e ekspertizës teknike dhe i vë në dispozicion kësaj shoqërie dokumentacionin teknik që zotëron.

Neni 19

Marrëdhëniet me administratën publike

Në përmbushjen e detyrave, PMNZSH-ja bashkëpunon me të gjitha strukturat e administratës publike, si dhe me personat juridikë e fizikë vendas ose të huaj, nëpërmjet akteve nënligjore e normative, duke lidhur marrëveshje e kontrata me detyrim të ndërsjelltë.

Neni 20

Lidhja e kontratës dhe tarifat

1. Personat juridikë ose fizikë, vendas ose të huaj, lidhin kontratë me PMNZSH-në për dhënien e asistencës teknike dhe vënien në dispozicion të personelit e të teknikës zjarrfikëse.

2. Tarifat për llojet e shërbimeve që kryhen ndaj të tretëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

Marrëdhëniet me njësitë e qeverisjes vendore

1. Organet e PMNZSH-së së qarkut bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, si dhe për zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të dispozitave të tjera të veçanta.

2. Aktet e organeve të qeverisjes vendore janë të detyrueshme për PMNZSH-në e qarkut, derisa ato përputhen me detyrat e saj të parashikuara në këtë ligj dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

KREU IV

DETYRAT E ORGANEVE QENDRORE DHE VENDORE

Neni 22

Ministri i Pushtetit Vendor

1. Ministri i Pushtetit Vendor përgjigjet përpara Këshillit të Ministrave dhe drejton shërbimin e PMNZSH-së në shkallë vendi.

2. Ministri i Pushtetit Vendor nxjerr urdhra dhe udhëzime me karakter të përgjithshëm për shërbimin e PMNZSH-së, të detyrueshme për ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, për organet e qeverisjes vendore dhe për subjektet e tjera.

Neni 23

Ministritë dhe institucionet qendrore

Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, ministritë dhe institucionet qendrore, në objektet e linjës së tyre, kanë këto detyra:

a) Organizojnë punën dhe marrin masa për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregulloreve për mbrojtjen nga zjarri.

b) Planifikojnë fonde financiare për përmirësimin e infrastrukturës së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit.

c) Nxjerrin urdhra e udhëzime për caktimin e rregullave për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin.

ç) Në studimet urbanistike dhe në projektet e veprave që miratohen prej tyre kanë edhe studimin për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, si dhe parashikojnë fondet financiare për këtë qëllim.

d) Organizojnë, në bashkëveprim me specialistët e PMNZSH-së, kontrole të specializuara, për caktimin e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në objektet e linjës së tyre.

dh) Planifikojnë dhe dërgojnë në kurse kualifikimi për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin specialistë e punonjës të subjekteve të tyre. Shpenzimet për kualifikimin e tyre përballohen nga vetë subjektet.

e) Marrin në analizë gjendjen e masave të sigurisë nga zjarri në objektet e linjës së tyre.

ë) Zhvillojnë në sistemin e arsimit të mesëm programin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin dhe në arsimin 8-vjeçar të japin njohuri për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në lëndën e edukatës qytetare.

Neni 24

Organet e pushtetit vendor

Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, organet e pushtetit vendor kanë këto detyra kryesore:

a) Sigurojnë zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe marrin masa për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në objektet që kanë në administrim ose në pronësi.

b) Financojnë ngritjen, mbajtjen dhe funksionimin e stacioneve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, sipas përcaktimeve në dispozita të veçanta.

c) Planifikojnë dhe japin fonde për përmirësimin e infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në bashki e komuna.

ç) Nxjerrin vendime, urdhra dhe urdhëresa të detyrueshme për zbatim nga personat juridikë dhe fizikë vendas ose të huaj, që kryejnë veprimtari në juridiksionin e tyre.

d) Vendosin lidhje dhe bashkëpunojnë me partnerë ose dhurues të shteteve të tjera, për të siguruar asistencë teknike, kualifikime e specializime për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, si dhe për furnizimin materialo-teknik të zjarrfikësve.

dh) Në studimet urbanistike dhe në projektet e veprave që hartohen dhe miratohen nga ana e tyre, të parashikojnë masat organizative e teknike dhe fondet financiare për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin.

e) Marrin në analizë gjendjen e masave të sigurisë nga zjarri dhe të shpëtimit dhe përcaktojnë detyra për përmirësimin e tyre në njësinë administrative.

ë) Kontrollojnë organizimin, funksionimin dhe zbatimin e detyrave të stacioneve të mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit, që kanë në varësi.

f) Kërkojnë dhe japin në raste zjarresh masive, emergjencash e fatkeqësish të tjera, ndihmë me automjete, pajisje e personel nga stacionet zjarrfikëse në bashkitë dhe komunat fqinje.

Neni 25

Detyrat e personave juridikë e fizikë, vendas ose të huaj

Personat juridikë dhe fizikë, vendas ose të huaj, detyrohen:

- a) të zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj, rregulloret dhe aktet e tjera normative për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin të nxjerra në zbatim të këtij ligji, si dhe normat ndërkombëtare teknike të pranuar;
- b) të kontrollojnë gjendjen e masave për sigurimin nga zjarri dhe shpëtimin;
- c) të planifikojnë fonde financiare për ndërtimin e infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, si dhe për përmirësimin e kësaj infrastrukture;
- ç) të pajisin objektet e tyre me sisteme sinjalizimi, sisteme ndërlidhjeje, sisteme stacionare automatike me hidrante zjarrfikëse për shuarjen e zjarreve dhe për shpëtimin, në përputhje me normat teknike, si dhe t'i mbajnë ato në gatishmëri;
- d) të hartojnë rregullat e brendshme për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, në përputhje me rrezikshmërinë e proceseve teknologjike dhe të kërkojnë zbatimin e tyre;
- dh) të shoqërojnë me certifikatë prodhimet e kimikateve e të lëndëve me rrezik të theksuar zjarri dhe shpërthimi, ku të përshkruhen karakteristikat fiziko-kimike, mënyrat e ruajtjes, transportimit dhe përdorimit të tyre.

KREU V

MASAT PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE PËR SHPËTIMIN NË PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN E VEPRAVE

Neni 26

Studimet urbanistike

Studimi për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin është pjesë përbërëse e studimeve urbanistike. Në to parashikohet zbatimi i dispozitave të këtij ligji, normave, rregulloreve teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, si dhe i normave ndërkombëtare të pranuar.

Neni 27

Projektimi, ndërtimi dhe vënia në shfrytëzim e veprave

1. Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në shfrytëzim e veprave dhe e objekteve të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor elektrik, ujësjellës-kanalizimeve etj. bëhen në përputhje edhe me kërkesat e këtij ligji, me normat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, me rregullat dhe normat ndërkombëtare teknike, si dhe me rregullat e përcaktuara në dispozita të veçanta.
2. Projektet, për të gjitha llojet e ndërtimeve, përfshijnë edhe projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

Neni 28

Moszbatimi i detyrave në projekt

Objektet që paraqesin rrezik, me pasojë për jetën e njerëzve dhe të pasurisë, nga mosriparimi ose mosrikonstruktimi nga personat juridikë e fizikë, që i kanë në pronësi e administrim ose nga moszbatimi i akteve, ligjore e nënligjore, për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, brenda afatit të përcaktuar nga raportet teknike të specialistëve të mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit bllokohen ose shemben, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën".

Neni 29
Ndryshimi i destinacionit

Çdo ndryshim i destinacionit të objekteve në përgjithësi, bërja e ndryshimeve funksionale, ndërtimore, teknologjike etj., të cilat nuk janë në përputhje me destinacionin e miratuar në Këshillin e Rregullimit të Territorit, bëhet vetëm pasi të merret leje edhe në PMNZSH.

Neni 30
Nënshkrimi nga PMNZSH-ja i lejeve të ndërtimit

1. PMNZSH-ja kundërfirmos në çdo rast, studimet urbanistike, planet rregulluese, projektet e zbatimit, sipas dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”.

2. Drejtori i PMNZSH-së nënshkruan projektet të cilat janë hartuar nga institucionet qendrore të projektimit, të përcaktuara në dispozita të veçanta dhe që miratohen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit .

3. Shefi i sektorit të PMNZSH-së së qarkut nënshkruan projektet e dala nga institucionet e projektimit dhe nga zyrat e urbanistikës së qarqeve e të bashkive dhe që miratohen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të qarkut dhe të bashkisë.

Neni 31
Kontrolli teknik pas përfundimit të punimeve

PMNZSH-ja, me përfundimin e punimeve të veprës ose të objektit, kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të detyrave të lëna për mbrojtjen nga zjarri e për shpëtimin. Në rast se vë re shkelje të normave ose moszbatim të detyrave të lëna, merr masat sipas përcaktimeve në këtë ligj. Ajo ndalon vënien në funksionim të objektit deri në plotësimin e kërkesave dhe gjosit investitorin ose shoqërinë ndërtuese.

Neni 32
Përgjegjësia e PMNZSH-së

1. Shefi i PMNZSH-së së qarkut mban përgjegjësi për dhënien e pëlqimit dhe për nënshkrimin e lejeve për sheshe ndërtimi, vepra e objekte, kur në to nuk respektohen dispozitat e këtij ligji.

2. Drejtorja e PMNZSH-së zgjidh konfliktet e personelit të saj vendor të mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit me personat juridikë ose fizikë, vendas ose të huaj.

KREU VI
DETYRAT DHE TË DREJTAT E PMNZSH-së

Neni 33
Detyrat

PMNZSH-ja ka këto detyra kryesore:

a) Organizon dhe drejton punën për zbatimin e ligjshmërisë, të normave e të rregulloreve për mbrojtjen e jetës së njerëzve e të pronës nga rreziku i zjarrit dhe jep asistencë teknike në këtë fushë.

b) Organizon punën për shuarjen e zjarreve dhe për shpëtimin në raste emergjencash dhe fatkeqësish të tjera.

c) Bashkëpunon me institucionet e tjera qendrore të administratës publike dhe me njësitë e qeverisjes vendore në fushën e mbrojtjes nga zjarri e të shpëtimit.

ç) Bën studime në fushën e mbrojtjes nga zjarri e të shpëtimit dhe bashkëpunon me institucionet studimore, shkencore, projektuese e me organizma simotra ndërkombëtare.

d) Ndhmon organet e hetimit, me kërkesën e tyre, në cilësinë e ekspertit, për sqarimin e rrethanave dhe të shkaqeve të rënies së zjarrit dhe bën aktin e ekspertizës teknike.

dh) Bashkëpunon me sektorë të tjerë të Policisë së Shtetit, me policinë bashkiake e policitë e tjera, me shërbimin e urgjencës shëndetësore etj. për shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës nga zjarri, nga rreziqet teknologjike, nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

e) Bashkëvepron me Policinë e Shtetit, policitë e tjera, shërbimin shëndetësor dhe shërbime të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ë) Njofton rregullisht publikun për detyrat dhe masat në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, fatkeqësish natyrore, teknologjike etj., si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste.

Neni 34 Të drejtat

1. PMNZSH-ja ka këto të drejta:

a) Jep pëlqimin dhe nënshkruan dokumentacionin teknik që hartohet për sheshe ndërtimi e ndërtim veprash, objekteve, institucioneve, banesash etj., sipas dispozitave të veçanta.

b) Jep aktin teknik të plotësimit të normave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për të gjitha objektet para vënies së tyre në shfrytëzim.

c) Ndërpret veprimtarinë në të gjitha kategoritë e proceseve teknologjike të veprave, e objekteve dhe institucioneve, kur ato paraqesin rrezik për jetën e njerëzve, të pronës dhe kur në to nuk janë zbatuar dispozitat e këtij ligji, deri në plotësimin e tyre.

ç) Bllokon mjete transporti tokësor, detar dhe ajror kur ato paraqesin rrezik zjarri dhe shpërthimi e kur në to nuk janë respektuar normat dhe rregulloret e mbrojtjes nga zjarri e të shpëtimin.

d) Bllokon të gjitha mjediset ku ka rënë zjarr, për të ruajtur të paprekur vendin e ngjarjes.

dh) Urdhëron largimin e menjëhershëm nga mjediset publike të pajisjeve, të materialeve e të lëndëve të rrezikshme, që sjellin pasoja për jetën e njerëzve e të pronës, si të lëndëve plasëse, të municioneve, të helmeve të forta, të lëngjeve lehtësisht të ndezshme e të djegshme, të lëndëve radioaktive etj.

e) Merr masa administrative ndaj kundërvajtësve sipas dispozitave të veçanta të këtij ligji.

2. Drejtoria e PMNZSH-së, në bazë të kërkesës dhe në përputhje me kriteret e miratuara, pajis shtetas me leje për ushtrimin e profesionit ekspert në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin. Kriteret profesionale dhe objekti konkret i veprimtarisë përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Pushtetit Vendor.

3. Drejtoria e PMNZSH-së, në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në kontratë, u jep personave fizikë e juridikë vendas ose të huaj lejen për prodhimin, mirëmbajtjen dhe tregtimin e teknikës, të pajisjeve dhe të lëndëve që nevojiten për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin. Kriteret e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Pushtetit Vendor.

KREU VII TRAJTIMI I PUNONJËSVE TË PMNZSH-SË

Neni 35

Rregullimi i pagave, përfitimet shtesë, koha e punës, koha e pushimit dhe pensioni

Pagat, përfitimet shtesë, koha e punës dhe e pushimit, si dhe dhënia e pensionit për punonjësin e PMNZSH-së, njehsohen me ato të Policisë së Shtetit.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 36

Përqendrimi i forcave dhe i mjeteve

Me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Vendor, Këshilli i Ministrave bën përqendrimin e forcave dhe të mjeteve të PMNZSH-së për përballoimin e emergjencave dhe të fatkeqësive të tjera.

Neni 37

Përdorimi në nevojë

1. Prefekti, për nevoja emergjente, të cilat nuk përballohen nga strukturat e PMNZSH-së që vepronë në territorin e qarkut, urdhëron dhe mjetet e personave fizikë e juridikë që ushtrojnë veprimtari në territorin përkatës.

2. PMNZSH-ja përdor, për nevoja të ngutshme të kryerjes së detyrës, mjete transporti e ndërlydhje të personave fizikë e juridikë, që ndihmojnë në shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës dhe në shuarjen e zjarrit, kundrejt shpërblimit.

Neni 38

Veprimi administrativ

1. Kur oficeri i PMNZSH-së vëren shkelje administrative, për të cilat dispozitat e këtij ligji e ngarkojnë me këto detyra, ai vendos masa administrative dhe masa të tjera të parashikuara në ligj, si gjobë, procedim administrativ, bllokim ose ndërprerje të veprimtarisë.

2. Për shkeljet e parashikuara në nenin 25, oficeri i PMNZSH-së ka të drejtë të japë gjobë të menjëhershme nga 500 deri në 5 000 lekë.

3. Për shkeljet e parashikuara në nenet 25, 27, 29 e 31 oficeri i PMNZSH-së jep gjobë, me vendim nga 5 000 deri në 100 000 lekë.

Ai jep po këtë gjobë në rastet kur:

a) nuk janë zbatuar detyrat e lëna me aktkontroll;

b) ka rënë zjarr për shkak të shkeljeve të rregullave teknike të mbrojtjes nga zjarri e të shpëtimit;

c) janë bllokuar rrugët e kalimit si rezultat i kryerjes së punimeve të ndërtimit.

4. Oficeri i PMNZSH-së bën bllokimin e çdo kategorie objekti, kur ai paraqet rrezik të theksuar për rënie zjarri e shpërthimi dhe kur nuk janë zbatuar detyrat e lëna që përbëjnë shkelje sipas neneve 26, 27, 28, 29, 31 dhe 37 pika 2 të këtij ligji.

5. PMNZSH-ja bën kallzim penal për shkeljet e parashikuara në nenet 28, 31 dhe 38 të këtij ligji.

6. Të drejtën e vënies së gjobës të menjëhershme dhe të mbajtjes së procesverbalit e kanë shefat e PMNZSH-së, inspektorët e parandalimit dhe komandantët e stacioneve.

Neni 39

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative

Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative bëhet nga shefi i sektorit të PMNZSH-së së qarkut, i cili vendos masën e gjobës sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ekzekutimi i këtyre gjobave bëhet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 40

Apelimi

1. Kundër vendimit të marrë nga shefi i sektorit të PMNZSH-së të qarkut bëhet ankim

brenda 10 ditëve nga data e komunikimit në Drejtorinë e PMNZSH-së në Ministrinë e Pushtetit Vendor.

2. Kundër vendimit të marrë nga drejtori i PMNZSH-së në Ministrinë e Pushtetit Vendor, kundërvajtësi ka të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor.

Neni 41

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Pushtetit Vendor, ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, prefektët dhe kryetarët e bashkive e të komunave të nxjerrin akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 42

Shfuqizime

Ligji nr.7707, datë 17.5.1993 “Për mbrojtjen nga zjarri” shfuqizohet.

Neni 43

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2971, datë 18.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J

Nr.8767, datë 5.4.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7971, DATË 26.7.1995 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8039, DATË 23.11.1995, NR.8074, DATË 22.2.1996 DHE NR.8112, DATË 28.3.1996

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, ndryshuar me ligjet nr.8039, datë 23.11.1995, nr.8074, datë 22.2.1996 dhe nr.8112, datë 28.3.1996, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

“Neni 1

Ky ligj përcakton rregullat për prokurimet e mallrave, të ndërtimeve dhe të shërbimeve dhe synon:

- a) të nxisë përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike nga entet prokuruese;
- b) të nxisë pjesëmarrjen e kandidatëve në procedurat e prokurimit publik;
- c) të nxisë konkurrencën në prokurim ndërmjet kandidatëve për furnizimin me mallra, për ndërtime dhe për shërbime;
- ç) të sigurojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në prokurim;
- d) Të sigurojë ndershmërinë, besimin publik dhe arritjen e transparencës në prokurimin publik.”

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

“Fonde publike” do të thotë:

- a) Çdo vlerë monetare e Buxhetit të Shtetit që është përcaktuar të përdoret për prokurim publik.
- b) Çdo vlerë monetare e buxhetit vendor që është përcaktuar të përdoret për prokurim publik.
- c) Fondet e dhëna si ndihmë ose kredi nga donatorë të huaj, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, në të cilat nuk kërkohen të zbatohen procedura të ndryshme nga ky ligj.
- ç) Të ardhurat e ndërmarrjeve shtetërore, të ndërmarrjeve bashkiake dhe të shoqërive tregtare, me përbërje kapitali në të cilën shteti ka shumicën.”

- Pas paragrafit të fundit shtohen paragrafët e mëposhtëm:

“Pezullim” do të thotë ndërprerje e procedurës së prokurimit nga kryetari i entit prokurues, nga organi qendror ose vendor ose nga Agjencia e Prokurimit Publik, si rezultat i ankimit administrativ.

“Rivlerësim” do të thotë rishikim dhe korrigjim i të metave të vëna re nga kryetari i entit prokurues, nga organi qendror ose vendor ose nga Agjencia e Prokurimit Publik në një procedurë prokurimi.

“Anulim” do të thotë përsëritje nga fillimi i një procedure prokurimi, si rezultat i shkeljeve të rregullave të prokurimit, të vëna re nga organi qendror ose vendor, ose nga Agjencia e Prokurimit Publik.”

Neni 3

Pas pikës 2 të nenit 5 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Enti prokurues, në fillim të çdo viti, sipas afateve të vendosura në rregullat e prokurimit publik, sjell në Agjencinë e Prokurimit Publik planifikimin vjetor të prokurimeve për publikim në Buletinin e Prokurimit Publik.”

Neni 4

Pas pikës 3 të nenit 7 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Enti prokurues është i detyruar të ngrejë njësinë e prokurimit brenda strukturave të veta, detyrat e së cilës përcaktohen në udhëzimet e Këshillit të Ministrave.”

Neni 5

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

Në shkronjën “c” të pikës 2 shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Në fillim të çdo viti Agjencia e Prokurimit Publik boton në Buletinin e Prokurimit Publik listën e ofertuesve, të përjashtuar nga marrja pjesë në prokurimet publike, sipas nenit 12 pika 5 dhe 7 të këtij ligji.

Pas shkronjës “g” të pikës 2 shtohen paragrafët “gj” dhe “h” me këtë përmbajtje:

“(gj) krijon një sistem të dhënash për statistikat për prokurimet publike, të marra nga institucionet publike qendrore dhe vendore;

(h) nxit dhe mbështet përdorimin e standardeve teknike ndërkombëtare për përgatitjen e specifikimeve teknike, si dhe mban lidhje të vazhdueshme me Drejtorinë Kombëtare të Standardizimeve.”

Neni 6

Në nenin 12 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në pikën 5, në fjalinë e parafundit fjalët “deri në 1 vit” bëhen “nga një deri 3 vjet”.

Pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Agjencia e Prokurimit Publik, kur vëren se skualifikimi i kandidatëve është bërë në përputhje me nenin 12 pika 5 ose kur vëren se një kandidat paraqet një dokument me informacion të remë, merr vendim për përjashtimin e kandidatit nga prokurimet publike për një periudhë kohe nga një vit deri në 3 vjet. Vendimin që ajo merr ua komunikon të gjitha enteve prokuruese nëpërmjet botimit në Buletinin e Prokurimit Publik.”

Neni 7

Në nenin 16 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si vijon:

“Veprimet korruptive”

2. Pas paragrafit ekzistues shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Çdo shpërblim i dhënë ose i marrë për përfitim vetjak nga nëpunësit e enteve prokuruese ose të organeve nga të cilat ato kanë varësi, si stimul për një akt, vendim ose procedurë prokurimi, quhet veprim korruptiv dhe, kur nuk përbën vepër penale, vlerësohet si shkelje administrative dhe dënohet sipas dispozitave të këtij ligji.”

Neni 8

Në nenin 17 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pika 3 ndryshohet si vijon:

“3. Këshilli i Ministrave, në raste të veçanta, emergjente ose të forcave madhore, mund të lejojë përdorimin e një procedure prokurimi, përveç tenderit të hapur në situatat e parashikuara në nenet 18, 19, 20, 21 dhe 22.

Lejimi i një procedure prokurimi duhet të shoqërohet me këto dokumente:

a) Kërkesa e entit prokurues për përdorimin e procedurës së zgjedhur të prokurimit dhe argumentet përkatëse për zgjedhjen e kësaj procedure.

b) Motivimi i entit prokurues për zgjedhjen e kandidatit ose të kandidatëve që do të marrin pjesë në prokurimin publik.

c) Treguesit që vërtetojnë regjistrimin në gjykatë të kandidatit ose të kandidatëve pjesëmarrës në prokurim, veprimtarinë e tyre, seriozitetin dhe besueshmërinë.

ç) Të dhënat për përcaktimin e fondit limit dhe për vëllimin e punës për ndërtimet.”

- Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Enti prokurues për objekte të mëdha publike, afati kohor i ndërtimit të të cilave kërkon vazhdimin e punimeve edhe në vitin kalendarik pasardhës, prokuron fondet për ndërtimet dhe supervizionin e tyre, sipas vlerës së plotë të këtyre objekteve. Çdo objekt i prokuruar për vlerën e plotë, shtrirë në më shumë se në një vit kalendarik, detyrimisht përfshihet në buxhetin e vitit pasardhës për vazhdimin dhe përfundimin e punimeve të tij.”

Neni 9

Në nenin 19 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“a) kur në mungesë të konkurrencës për arsye teknike, mallrat ndërtimet ose shërbimet sigurohen vetëm nga një kandidat ose kur një furnizues ose kontraktues ka të drejtën ekskluzive për mallrat për ndërtimet ose për shërbimet dhe nuk ekziston një mundësi tjetër zëvendësuese;”

- Shkronja “b” e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“b) Sipas kufizimeve të parashikuara në rregullat e prokurimit, për lëvrime shtesë të mallrave dhe të shërbimeve nga furnizuesi i mëparshëm, të cilat bëhen ose si zëvendësim, ose si shtim i mallrave dhe i shërbimeve ekzistuese, kur një ndryshim i furnizuesit do të detyronte entin prokurues të prokuronte mallra a shërbime, të cilat nuk do të plotësonin kërkesat e përshtatshmërisë me mallrat ose me shërbimet ekzistuese”.

- Pas shkronjës “e” të pikës 1 shtohen këta paragrafë:

“ë) enti prokurues do të përdorë procedurën e prokurimit të drejtpërdrejtë për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” të pikës 1 të këtij neni, vetëm pasi të ketë marrë miratimin nga Agjencia e Prokurimit Publik;

f) kur enti prokurues ka nevojë urgjente për mallra për ndërtime ose për shërbime të paparashikuara në planifikimin vjetor të prokurimeve dhe kur kjo nevojë urgjente është shkaktuar nga rrethanat jashtë kontrollit të entit prokurues, mund të përdorë prokurimin e drejtpërdrejtë, pasi të jetë marrë më parë miratimi nga Agjencia e Prokurimit Publik.”

Pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Enti prokurues mund të përdorë, gjithashtu, prokurimin e drejtpërdrejtë për prokurimet me vlera të vogla, kur vlera e përlogaritur është më e vogël se kufiri monetar i përcaktuar në rregullat e prokurimit.”

Neni 10

Pika 1 e nentit 25 ndryshohet si vijon:

“1. Ftesa për ofertë duhet t’u drejtohet të gjithë kandidatëve të cilët kanë shfaqur interesin e tyre me shkrim, për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi. Ftesa për ofertë duhet të botohet në Buletinin e Prokurimit Publik dhe të paktën në dy gazeta kombëtare me tirazh të madh.”

Neni 11

Fjalja e parë e pikës 1 të nenit 29 ndryshohet si vijon:

“Enti prokurues duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit kushtin e sigurimit të ofertës në formën e garancisë bankare ose të garancisë së lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve, të licencuara nga shteti.”

Neni 12

Pika 1 e nenit 31 ndryshohet si vijon:

“1. Enti prokurues duhet të hapë të gjitha ofertat në datën dhe në kohën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, të cilat vijnë menjëherë pas afatit të fundit të pranimit të tyre.”

Neni 13

Në nenin 32 bëhen këto ndryshime:

- Fjalja e parë e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“Enti prokurues kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, me qëllim që shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave të jetë i drejtë dhe transparent.”

- Në pikën 4 rreshti i parë, fjalët “mund ta konsiderojë” zëvendësohen me fjalët “konsideron”.

- Shkronja “b” e pikës 7 ndryshohet si vijon:

“b) oferta e cila në bazë të kërkesave, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kriteret dhe kushtet e veçanta të objektit të prokurimit me vlerën ekonomike më të mirë. Vlera ekonomike më e mirë vlerësohet në bazë të faktorëve të specifikuar në dokumentet e tenderit, të cilët duhet të jenë objektivë dhe të shprehur qartë nga ana sasiore, në atë shkallë që është e mundur, si dhe t’u jepet një peshë relative në procedurën e vlerësimit ose të shprehen me vlerën monetare.”

Neni 14

Pas pikës 3 të nenit 35 shtohen këto pika:

“4. Enti prokures, brenda 30 ditëve të nënshkrimit të formularit të kontratës, duhet të publikojë njoftimin e fituesit në Buletin e Prokurimit Publik. Kontrata për prokurimet publike quhet e lidhur, kur nënshkruhet nga enti prokures dhe nga ofertuesi fitues.

5. Për kontratën e prokurimit publik zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

6. Enti prokures ose organi, i cili vë në dispozicion fondet pas lidhjes së kontratës, ushtron mbikëqyrjen për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata.

7. Procedura e prokurimit përfundon, kur realizohen të gjitha detyrimet kontraktore të palëve.”

Neni 15

Në nenin 36 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Shkronja “b” ndryshohet si vijon:

“b) enti prokures, i cili ka lista të përditësuara, rregullisht, të paktën dy herë në vit, duhet të zgjedhë kandidatë nga këto lista dhe të pranojë oferta nga ata kandidatë të cilët kërkojnë të marrin pjesë në tender, duke u dhënë të gjithë pjesëmarrësve mundësi të barabarta konkurimi;”

- Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) enti prokures për zhvillimin ose jo të procedurave të prokurimit me më pak se tri oferta, duhet të marrë më parë miratimin e Agjencisë së Prokurimit Publik.”

Neni 16

Pika 3 e nenit 39 ndryshohet si vijon:

“3. Enti prokures mund të kryejë negociata me kandidatin fitues për përmbajtjen e propozimit të tij dhe mund të kërkojë ose të lejojë rishqyrtimin e këtij propozimi.”

Neni 17

Pika 1 e nenit 40 ndryshohet si vijon:

“1. Enti prokures duhet të kërkojë kuotime nga sa më shumë kandidatë që të jetë e mundur, për të siguruar jo më pak se tri oferta. Në rast se sigurohen më pak se tri oferta, enti prokures duhet të marrë miratimin e Agjencisë së Prokurimit Publik për vazhdimin ose jo të kësaj procedure.”

Neni 18

Pika 1 e nenit 41 ndryshohet si vijon:

“1. Enti prokures duhet të përdorë “Tenderin e hapur ndërkombëtar”, kur vlera e përlllogaritur e fondit limit është mbi një kufi monetar të përcaktuar në rregullat e prokurimit ose për fonde limite nën këtë vlerë monetare, ku konkurrenca e frytshme nuk mund të sigurohet në tenderin e hapur për prokurimin e mallrave, të ndërtimeve dhe të shërbimeve, pa pjesëmarrjen e personave fizikë ose juridikë të huaj.”

Neni 19

Pika 1 e nenit 45 ndryshohet si vijon:

“1. Agjencia e Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës së një kandidati ofertues në prokurimin publik, në rast se nuk e refuzon atë, njofton menjëherë entin prokurues të pezullojë veprimet e mëtejshme të prokurimit publik dhe i kërkon atij që, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, të depozitojë në Agjencinë e Prokurimit Publik të gjithë dokumentacionin që lidhet me procedurën e prokurimit.”

Neni 20

Neni 46 ndryshohet si vijon:

“1. Në rastet kur vërehen shkelje të dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të prokurimit, Agjencia e Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) t'i propozojë organit qendror ose vendor marrjen e masave ndëshkuese ndaj personave përgjegjës të entit prokurues, që kanë kryer kundërvajtje administrative;

b) të dënojë personat përgjegjës për kundërvajtje administrative me gjobë nga 50 mijë lekë deri në 1 milionë lekë. Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankesë në gjykatën e rrethit të entit prokurues brenda 5 ditëve nga njoftimi.

2. Titullari i organeve qendrore ose vendore, si dhe titullari i entit prokurues, kur vëren shkelje të këtij ligji dhe të rregullave të prokurimit, ka të drejtë:

a) të dënojë personat përgjegjës të entit prokurues për kundërvajtjet administrative me gjobë nga 50 mijë lekë deri në 100 mijë lekë. Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim në Agjencinë e Prokurimit Publik, e cila shqyrton ankimin brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tij;

b) të largojë nga detyra personat përgjegjës për kundërvajtjet administrative.”

3. Vjelja e gjobave bëhet sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

4. Gjobat e parashikuara në këtë nen për të njëjtën shkelje jepet vetëm njëherë.”

Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2972, datë 18.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

V E N D I M

Nr.483, datë 2.4.2001

PËR CAKTIMIN E DEPUTETËVE QË DO TË MARRIN PJESË NË KOMISIONIN PËR DEKLARIMIN E PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 7 të ligjit nr.7903, datë 8.3.1995 “Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik” dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I :

I. Në përbërje të Komisionit për Deklarimin e Pasurive të të Zgjedhurve dhe disa Drejtuesve e Punonjësve të Shërbimit Publik zgjidhen këta deputetë:

Luan Shahollari
Zamira Çaka
Engjëll Bejtaj
Myslim Murrizi

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Skënder Gjinushi**

V E N D I M Nr.484, datë 2.4.2001

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVIZIONIT (KKRT)

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Mjetet e Informimit Publik,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I :

I. Zoti Lazër Stani zgjidhet në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Skënder Gjinushi**

D E K R E T Nr. 2973, datë 19.4.2001

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Dritan Bardhyl Morina – Obermoser
2. Artur Hasan Bardhoshi (Schaffer)
3. Besnik Sitki Gercaliu
4. Luljeta Mustafa Gercaliu (Bastari)
5. Ronald Besnik Gercaliu
6. Jonida Besnik Gercaliu
7. Musa Hasan Motina
8. Ermona Jonuz Stockel (Velja)
9. Luljeta Vehbi Korça (Trashani)
10. Ilir Jorgji Bidoshi
11. Kastriot Syti Hysenbelli
12. Paula Kastriot Hysenbelli
13. Klaudio Kastriot Hysenbelli
14. Engjellushe Ismail Hysenbelli (Sherifi)
15. Izabela Ali Balaj
16. Endrit Zyhdhi Pepa
17. Fatmir Rexhep Shaqiri
18. Engjellushe Sulejman Shaqiri (Hoxha)
19. Amardo Fatmir Shaqiri
20. Denida Fatmir Shaqiri
21. Anjeza Fatmir Shaqiri
22. Genti (Gent) Enver Halili
23. Myhybe Qemal Fero (Taho)
24. Anila Muntaz Iwert (Kokalari)
25. Piro Gaqo Jorgji
26. Albana Anastas Neto (Ristani)
27. Helena Adrian Neto
28. Bruno Adrian Neto
29. Alban Njazi Ganaj
30. Petrit Ali Xibraku
31. Arben Estref Manaj
32. Ridvan Telat Sakiqi
33. Violeta Aleks Sakiqi (Gjiçali)
34. Omar Ridvan Sakiqi
35. Mimoza Themë Laholli (Gjermani)

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr.2975, datë 20.4.2001

PËR EMËRIMIN E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM TË SHETIT

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 8 pika 1 të ligjit nr. 8551, datë 18.11.1999 “Për Avokaturën e Shtetit”, me propozim të Kryeministrit,

D E K R E T O J:

Zonja Flutura Kona emërohet Avokate e Përgjithshme e Shtetit

Neni 1

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr.2979, datë 20.4.2001

PËR LIRIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 98 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit Ilir Meta,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zotit Sokol Nako, Ministër i Transportit, lirohet nga kjo detyrë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr. 2980, datë 20.4.2001

PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 98, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit Ilir Meta,

D E K R E T O J:

Zoti Viktor Doda emërohet Ministër i Transporteve

Neni 1

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr.174, datë 30.3.2001

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në lidhjen I dhe në lidhjen II-5, në shkronjën B3, shtohet emërtimi "Shef i shërbimit mjeko-ligjor" dhe në shkronjën B4 të po këtyre lidhjeve, shtohen emërtimet: "specialist mjeko-ligjor", "specialist mjeko-ligjor psikiatër", "specialist toksikolog" dhe "specialist mjeko-ligjor pranë gjykatave". Këto emërtime në lidhjen III-5/28 shfuqizohen.

2. Tabela e pagave për punonjësit e shërbimit të ekspertimit mjeko-ligjor të jetë sipas lidhjes nr.24, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në fund të paragrafit të tretë të pikës 7, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: "Nuk përfitojnë nga këto shtesa mbi pagën në përqindje specialistët e shërbimit qendror të mjekësisë-ligjore dhe specialistët mjeko-ligjor pranë gjykatave".

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga ky vendim, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT QENDROR TË MJEKËSISË LIGJORE

Nr.	EMËRTIMI I PUNONJËSIT	KLASIFIKIMI	Klasa shtesë për funksion (grupi)
1.	Kryelaborant	VII	2
2.	Teknik-laborant,	VI	

Për punonjësit e tjerë të zbatohen pagat sipas lidhjes II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e Ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore” të vendimit nr.726, datë 21.12.2000.

V E N D I M
Nr.176, datë 30.3.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.531, DATË 21.8.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TOKAT BUJQËSORE TË PANDARA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara” dhe të shkronjës “a” të nenit 3 të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.531, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave bëhen shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 4, pas fjalisë “Sipërfaqet e tokave të pandara të evidentohen më vete”, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Sipërfaqet e evidentuara si të tilla, më 1.3.2001, nga komisioni i tokës në komunë apo në bashki dhe të vërtetuara nga përgjegjësi i zyrës së kadastrës, jepen me qira nga organet e qeverisjes vendore për personat, fizikë e juridikë, vendas apo të huaj”.

Procedurat për dhënien me qira të sipërfaqeve të tokës, të pandara, përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Sipërfaqen me toka të pandara, organet e qeverisjes vendore mund ta paracaktojnë për t’u shfrytëzuar edhe për livadhe, kullota ose pyje”.

Ndryshimi i zërit kadastral, nga tokë bujqësore në livadh, kullotë ose pyll, bëhet me miratimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, me propozimin e këshillit të komunës.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Pushtetit Lokal për përgatitjen e udhëzimit për procedurat e qiradhënies dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.178, datë 30.3.2001

PËR BASHKIMIN E QENDRËS KOMBËTARE TË EDUKIMIT DHE PROMOCIONIT TË SHËNDETIT ME INSTITUTIN E SHËNDETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 dhe 19 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994, “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Qendra Kombëtare e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit bashkohen me Institutin e Shëndetit Publik (ISHP)

2. I gjithë kapitali themelor e qarkullues, si dhe puna shkencore e Qendrës Kombëtare të Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit, vihen në administrimin e Institutit të Shëndetit Publik.

3. Ministri i Shëndetësisë të miratojë strukturën organizative dhe rregulloren përkatëse të propozuar nga këshilli drejtues i Institutit të Shëndetit Publik.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

U D H Ë Z I M
Nr. 23, Date 17.04.2001

**PËR MËNYRËN E VERIFIKIMIT NGA KZQV-TË TË REKORDEVE TË DUBLUARA
NË LISTEN A TË ZGJEDHËSVE**

Në mbështetje të nenit 41 pika 1 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

KZQV-të do të bëjnë verifikimin e rekordeve (zgjedhësve) të dubluar të listës A të zgjedhësve. Rekordet e dubluara janë printuar për çdo KZQV në dy lista :

Listën nr. 4

Listën nr. 5

Lista nr.4 përmban rekordet e dubluara brenda listës së çdo KZQV-je, kurse Lista nr.5 përmban rekorde, dublimet e të cilave ndodhen në listat e KZQV-ve të tjera.

Për verifikimin e dublimeve të Listës nr.4 do të vepohet në këtë mënyrë:

KZQV-ja do të çojë në Zyrën e Gjendjes Civile grupin tresh të verifikimit, i cili nëpërmjet emrit të regjistrit dhe numrit të faqes së tij ose nëpërmjet regjistrit me indeks do të përcaktojë adresat e rekordeve të dubluara dhe më pas do të bëjë verifikimin derë më derë të këtyre rekordeve.

Pas verifikimit ata duhet të përcaktojë se cili nga rekordet e dubluara është zgjedhës i vërtetë dhe cili dublim. Në kolonën e statusit ata shenojnë germën “V” për rekordin që është zgjedhës dhe germën “Për rekordin që është dublim i tij. Në rastet kur dy rekordet e verifikuara nuk janë i njëjti zgjedhës (pra nuk është dublim), atëherë ata në kolonën e statusit shënojnë germën “V” për secilin prej tyre. (Në rastin kur zgjedhësi ka pasur një mbiemër tjetër ai shkruhet në kolonën përkatëse). Në qoftë se të dy rekordet nuk janë banorë në adresat përkatëse, ata shënojnë germën “L” në kolonën e statusit.

KZQV-ja pasi merr Listën nr.4 të verifikuar nga grupi tresh, i hedh statuset e përcaktuara në këtë listë, në Listën nr.3.

Për verifikimin e dublimeve të Listës nr.5 do të vepohet në këtë mënyrë:

KZQV-ja do të çojë në Zyrën e Gjendjes Civile grupin tresh, të cilët, nëpërmjet emrit të regjistrit dhe numrit të faqeve se tij (ose nëpërmjet regjistrit me indeks) do të përcaktojë adresat e rekordeve të dubluara dhe, më pas, do të bëjnë verifikimin derë më derë të këtyre rekordeve.

Kur zgjedhësi kontaktohet, ata shkruajnë germën “V” në kolonën e statusit (kur zgjedhësi ka pasur një mbiemër tjetër ai shkruhet në kolonën përkatëse) dhe kur ai është i larguar (nuk banon më në atë vendbanim) shkruajnë germën “L”. KZQV-ja, pasi merr Listën nr.5 të verifikuar nga grupi tresh, i hedh statuset e përcaktuar në këtë listë, në Listën nr.3.

SHËNIM: Listat nr.4 dhe nr.5 do të firmosen faqe për faqe nga të tre anëtarët e grupit tresh te verifikimit. Në rast se një anëtar i saj ka kundërshtime, ai i shënon këto kundërshtime pas fletës përkatëse dhe i firmos ato.

U D H Ë Z I M
Nr.24 Datë, 18.04.2001

PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT 2001

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të pikës 5 të nenit 58 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”

U D H Ë Z O N :

Vënien në dispozicion të listave të zgjedhësve partive politike dhe subjekteve të tjera zgjedhore si vijon:

1.Listat paraprake te zgjedhësve

Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të qershorit 2001, partive politike, me kërkesën e tyre, iu vihet ne dispozicion një kopje e listës paraprake të zgjedhësve kundrejt pagesës së kostos së prodhimit. Bashklidhur kërkesës, duhet të jetë edhe urdhërpagesa e konfirmuar nga dega e thesarit Tiranë, për xhirimin në favor të KQZ-së të shumës përkatëse të mandatpagesës së lëshuar nga Drejtori i Regjistrat Kombëtar të Zgjedhësve.

Partita Socialiste dhe Partia Demokratike mund ta tërheqin kopjen e listës paraprake, sipas mënyrës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, brenda datës 25.4.2001.

2.Listat përfundimtare të zgjedhësve

Lista përfundimtare e zgjedhësve, e miratuar nga Komisioni Qendror Zgjedhjeve u vihet në dispozicion subjekteve zgjedhore, kundrejt kërkesës me shkrim të organit drejtues të partisë në qendër dhe urdhërpageses së konfirmuar nga dega e thesarit Tiranë, për likuidimin e 100 % të kostos së prodhimit të listës, brenda dy ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi

Fletorja Zyrtare gjendet:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 2.5.2001
Doli nga shtypi më 4.5.2001

Tirazhi: 4100 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta”, Tiranë

Çmimi: 150 lekë